

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore:

Shtator 2015

Modelet e Menaxhimit dhe Efektiviteti



Lista e Akronimeve

AZHK - Autoriteti i Zhvillimit Kreditor

FKGK - Fondi Kosovar për Garanci Kreditore

KfW (IKR) - Kreditanstalt für Wiederaufbau (Institucioni për Kredi të Rindërtimit)

MBPZHR - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

MTI - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

SECO (SSPE) - State Secretariat for Economic Affairs (Sekretariati Shtetëror për Çështje Ekonomik)

USAID(ASHBZHN) - United States Agency for International Development (Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar)

VI (IV) - Vienna Initiative (Iniciativa e Vienës)

Përmbledhje Ekzekutive

Normat e larta të interesit në kredi dhe qasja në financa mbeten njëra nga problemet kryesore të bizneseve kosovare. Me qëllim të përmirësimit të kësaj gjendje, Qeveria e Kosovës, përkatësisht Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) së bashku me donatorët ndërkombëtar ka inicuar krijimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK). Qëllimi i këtij fondi është që të rrisë kreditimin e bizneseve, duke garantuar deri 50% të kryegjësë (borxhit) të bizneseve ndaj bankës. Sipas projekteve të MTI-së, për gjashtë vitet e para FKGK-ja do të mundësojë 360 milionë euro kredi të reja të cilat kanë potencial për të krijuar deri në 20 mijë vende të reja të punës.

Përvojat e vendeve tjera tregojnë se këto fonde në përgjithësi nuk kanë ndikuar në rritjen e kredive jo-performuese, mirëpo ka pasur raste kur efekti pozitiv në rritjen e investimeve ka munguar. Në përgjithësi, vendet e zhvilluara, me sistem më të qëndrueshëm financiar dhe bankar, kanë qenë më të suksesshme në krijimin dhe rritjen e bizneseve të reja dhe si rezultat edhe në krijimin e vendeve të punës. Në Kosovë një fond i ngjashëm ka ekzistuar edhe më herët (i quajtur Autoriteti për Zhvillim Kreditor), dhe ka pasur sukses të pjesërishëm për arsye të kapaciteteve të kufizuara financiare për të garantuar kredi krahasuar me nevojën për kreditim. Gjithashtu, megjithëse synimi i këtij fondi ka qenë që normat e interesit në kredi për bujqësi të ulen për 10%, ky fond ka arritur t'i zbrësë ato vetëm 3-5%.

Krahasuar më mënyrat tjera të financimit, përvojat e vendeve të tjera kanë treguar që fonde të tilla garantuese preferohen më shumë se sa subvencionet. Kjo për shkak se kreditë administrohen nga bankat komerciale dhe këto janë më efektive dhe efikase se agjencitë publike në shpërndarjen e fondeve në vendet e duhura.

Duke u bazuar në këto përvoja dhe marrë parasysh kapacitetet financiare të FKGK-së, Instituti GAP vlerëson se ky fond nuk pritët të ketë ndikim të madh në rritjen e kreditimit. Instituti GAP rekomandon se krahas implementimit të këtij fondi, paralelisht të përmirësohet edhe ambienti i të bërit biznes në Kosovë, sidomos sa i përket zbatimit të ligjit, uljes së informalitetit dhe forcimit të sistemit bankar. Instituti GAP gjithashtu rekomandon që si aksionarë të përfshihet edhe sektori privat, e sidomos bankat komerciale.

1. Hyrje

Bizneset e vogla dhe të mesme, e sidomos bizneset e reja, kanë shumë vështirësi të kenë qasje në mjete financiare përmes bankave. Normat e interesit për kredi, që ishin 10.6% në qershor 2014¹ dhe rreth 10% më 2015², konsiderohen si të larta për këto biznese. Kjo normë interesi është ndër më të lartat në rajon³. Mbi 50% e portfolios së kredive, i takon sektorit të tregtisë. Ndërsa sektori i bujqësisë, si pjesë e sektorit prodhues, përbën vetëm 3.6% të kredive⁴. Raporti i kredive ndaj depozitave totale në bankat e Kosovës është 78.1%⁵. Kjo tregon se bankat komerciale kanë likuiditet të pashfrytëzuar. Për më tepër, bizneset kanë listuar normat e larta të interesit dhe vështirësitë në qasje në financa si dy nga sfidat më të mëdha.⁶

Për të adresuar këtë problem, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) ka shpallur planet rreth themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë (FKGK). Shuma e këtij fondi do të jetë rreth 19 milionë euro, 18 milionë prej të cilave do të vijnë si donacion prej USAID-it, Kfw-së dhe SECO-së dhe 1 milion prej vetë Ministrisë. FKGK-ja do të marr përsipër deri në 50% të kolateralit ose rrezikut për kreditë e aprovuara, dhe rrjedhimisht edhe të humbjeve eventuale. Përmes FKGK-së, Ministria synon që t'i zvogëlojë vështirësitë që bizneset i hasin në qasje në mjete financiare, një problem ky që i pengon bizneset që të zgjerohen. Sipas projekteve të Ministrisë, për gjashtë vitet e para FKGK-ja do të mundësojë 360 milionë euro kredi të reja të cilat kanë potencial për të krijuar deri në 20 mijë vende të reja të punës⁷.

Qëllimi i kësaj analize është që, duke u bazuar në përvojat e menaxhimit të fondeve të ngjashme në Kosovë dhe më gjerë, të identifikohen disa nga sfidat që ndërlidhen me implementimin e FKGK-së, si dhe të ofrohen rekomandime për menaxhimin e tij.

¹ Banka Qendrore e Kosovës "Raporti i Stabilitetit Financiar" No. 6, Dhjetor 2014

² Banka Qendrore e Kosovës "Buletini Mujor Statistikor" No.166, Qershor 2015

³ World Development Indicator, Real Interest Rates. Burimi: <http://bit.ly/1Pc1M8S>

⁴ Banka Qendrore e Kosovës "Raporti i Stabilitetit Financiar" No. 6, Dhjetor 2014

⁵ Banka Qendrore e Kosovës "Raporti i Stabilitetit Financiar" No. 6, Dhjetor 2014, fq. 47

⁶ Instituti Riinvest "Performanca, Barrierat, dhe Besueshmëria e Bizneseve në Kosovë", 2013, Burimi: <http://bit.ly/1Mk41lr>

⁷ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë "Koncept-Dokument për Fushën e Themelimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë"

2. Si do të funksionojë FKGK-ja

Më 17 qershor 2015 MTI-ja ka publikuar koncept-dokumentin për FKGK-në, në të cilin shpjegon arsyet dhe disa opsione për themelimin e një fondi të tillë. Sipas MTI-së, qëllimi kryesor i FKGK-së është që të lehtësojë qasjen në financa të bizneseve të vogla dhe të mesme, bizneseve të reja, bizneseve të grave, si dhe sektorit të bujqësisë. Duke shërbyer si urë lidhëse mes këtyre bizneseve dhe bankave komerciale, FKGK-ja synon të stimulojë ekonominë kosovare, duke rritur investimet dhe nivelin e punësimit, dhe duke e përmirësuar bilancin tregtar të Kosovës. Sipas projekteve të MTI-së, për gjashtë vitet e para, FKGK-ja do të mundësojë 360 milionë euro kredi të reja të cilat kanë potencial për të krijuar deri në 20 mijë vende të reja të punës.

Në koncept-dokument janë paraqitur dy opsione për themelimin e FKGK-së, përkundër opsionit fillestar që të mos ketë fare mekanizëm garantues kreditor. Sipas opsionit të dytë, FKGK-ja do të themelohej bazuar në një ligj që do të votohej në parlament. Ky fond do të themelohej si subjekt i pavarur nga Qeveria, me autonomi të plotë, nën mbështetjen e Ministrisë, si dhe të USAID-it, Kfw-së, e SECO-së si donatorë. FKGK-ja më vonë do të bëhet financiarisht i vetë-qëndrueshëm, përmes tarifave që paguhen nga bankat që lëshojnë kredi me garancinë e fondit. Procedurat e marrjes së garancisë do të integroheshin në procedurat e brendshme të bankave⁸. Sipas projekteve të Ministrisë, parashihet që FKGK-ja të gjenerojë profit deri në 280 mijë euro për gjashtë vitet e para⁹.

Sipas opsionit të tretë, Qeveria së bashku me sektorin privat do të ndihmonin në themelimin e një shoqërie aksionare ose organizate jo-qeveritare. Në parim, funksioni do të mbetej i njëjtë si në opsionin e dytë. Por, sipas MTI-së, sektori privat nuk ka treguar interes për të ndërmarrë një iniciativë të tillë, për këtë arsye Ministria sugjeron që të vazhdohet me opsionin e dytë¹⁰.

Draftligji për FKGK-në paraqet bazën dhe kërkesat ligjore të funksionimit të FKGK-së. Përmes këtij draft-ligji qartësohet struktura e FKGK-së si dhe procedurat e marrjes së garancisë. FKGK-ja do të menaxhohet nga Drejtori Menaxhues, puna e të cilës do të

⁸ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Intervistë me Ilir Salihun, 15 Korrik 2015

⁹ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Intervistë me Ilir Salihun, 15 Korrik 2015

¹⁰ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë “Koncept-Dokument Për Fushën E Themelimit Të Fondit Kosovar Për Garanci Kreditorë”

mbikëqyret nga Bordi Menaxhues. Njëra prej obligimeve të FKGK-së do të jetë aprovimi ose refuzimi i kërkesave prej bankave për rimbursim të kredive të garantuara që nuk janë kthyer. Kusht për aprovim të kërkesës do të jetë plotësimi i kriterëve të specifikuar në nenin 6 të këtij draft-ligji. Bankat do ta marrin vendimin se cilët klient t'i vendosin nën garancinë e FKGK-së, përderisa FKGK-ja do të ketë rol mbikëqyrës në këtë proces¹¹.

3. Përvoja me Autoritetin për Zhvillim Kreditor

Një fond i ngjashëm me FKGK-në tashmë ekziston në Kosovë. Më 26 shtator 2012, u nënshkrua marrëveshja në mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), USAID-it dhe gjashtë bankave komerciale në Kosovë (Raiffeisen Bank, TEB, ProCredit Bank, BKT, NLB dhe Banka Ekonomike) për themelimin e Autoritetit për Zhvillim Kreditor (AZHK) që synonte lehtësimin e qasjes në financa për fermerët dhe agrobizneset. Ky projekt do të përfundojë në vitin 2020.

AZHK ka qasje në 21 milionë euro të siguruara nga USAID-i dhe 2.5 milionë euro të dhuruara nga MBPZHR. AZHK mbulon 50% të kredisë në të gjitha rastet dhe synon agrobizneset dhe fermerët komercialë që kanë potencial për t'u rritur¹². Në bazë të marrëveshjes, kreditë të cilat mbulohej prej AZHK-së, duhet të kenë vlerë në mes 5,500 euro deri 180 mijë euro. Pra, çdo kredi në mes të këtyre vlerave kualifikohet për t'u mbuluar nga AZHK-ja, gjithmonë nëse plotësohen kriteret tjera të caktuara nga bankat individuale. Për shembull, banka ProCredit, kërkon nga kredimarrësit që janë mbuluar nga AZHK-ja të jenë poashtu biznese të regjistruara.¹³

Bankat që bashkëpunojnë me USAID dhe MBPZHR në këtë projekt është dashur të paguajnë një tarifë pas alokimit të fondit si dhe një tarifë për kreditë e dhëna që janë vendosur nën garancinë e AZHK-së gjatë një viti. Sa më i lartë rreziku për kredi joperformuese, aq më e lartë tarifa.¹⁴

Vendimin për t'i futur kreditë e caktuara nën garancinë e AZHK-së e marrin vetë bankat. Mirëpo, këto banka raportojnë tek USAID-i çdo

¹¹ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë "Projektligji Për Themelimin E Fondit Kosovar Për Garanci Kreditorë"

¹² USAID, Intervistë me një zyrtar të USAID-it, 9 Korrik 2015

¹³ ProCredit Bank Kosova, Intervistë me Shpend Xharrën dhe Armend Hoxhën, 3 Korrik 2015.

¹⁴ USAID, Intervistë me një zyrtar të USAID-it, 9 Korrik 2015.

gjashtë muaj për secilën kredi të dhënë të garantuar nga fondi i AZHK-së. Njëkohësisht, USAID-i mban të drejtën të refuzojë që të garantojë një kredi të cilën banka e ka vënë nën garancionin e AZHK-së, në rast se e sheh se standardet e vendosura sipas marrëveshjes nuk janë përmbushur.

AZHK-ja nuk e ka rritur numrin e kredive jo-performuese, përkundër faktit që mekanizmat garantues pritet t'i rrisin kreditë e tilla. Nga 193 kredi të dhëna me garancinë e AZHK-së, prej 2012 deri në mars të 2015 në ProCredit, vetëm pesë janë joperformuese¹⁵. Banka Ekonomike, edhe pse nuk e ka shfrytëzuar komplet fondin, poashtu raporton se nuk ka pasur kredi joperformuese¹⁶. Banka Raiffaisen ka pasur përqindje të ulët të kredive joperformuese, mirëpo këtë përqindje ia atribuon edhe faktorëve të tjerë si përmbaruesve privat, bashkëpunimin e ndërtuar me klientët dhe edukimit të përgjithshëm të klientëve për kthim të kredive¹⁷. Në këtë përqindje të ulët të kredive joperformuese ka ndikuar edhe fakti që klientët e disa bankave nuk janë informuar fare se kredia e tyre është vendosur nën garancinë e AZHK-së.

Në përgjithësi, programi i AZHK-së ka qenë i suksesshëm, ndonëse fondi i alokuar për AZHK-në ka qenë shumë i vogël krahasuar me nevojat e bizneseve për financim. Sa për krahasim, gjatë tri viteve të bashkëpunimit me AZHK-në, ProCredit-i ka dhënë kredi në vlerë afërsisht gjashtë milion euro, vlerë kjo e njëjtë e kredive që jep kjo bankë për një tremujor në fushën e bujqësisë¹⁸.

Ndonëse ndikimi i programit ka qenë pozitiv, nuk mund të thuhet se ka sjellë ndryshim substancial në ekonominë kosovare. Gjithashtu, AZHK-ja pat premtuar t'i ulë normat e interesit për 5-10% për klientët që vendosen nën garancinë e këtij fondi. Mirëpo, normat e interesit janë ulur vetëm për 3-5%¹⁹.

¹⁵ ProCredit Bank Kosova, Intervistë me Shpend Xharrën dhe Armend Hoxhën, 3 Korrik 2015.

¹⁶ Banka Ekonomike, Intervistë me Shpend Kusarin, 21 Korrik 2015.

¹⁷ Raiffaisen Bank, Intervistë me Bujar Shkodrën, 22 Korrik 2015.

¹⁸ ProCredit Bank Kosova, Intervistë me Shpend Xharrën dhe Armend Hoxhën, 3 korrik 2015.

¹⁹ Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Intervistë me Ekrem Gjokaj, 8 korrik 2015.

4. Përvojat e vendeve tjera

Studimet tregojnë se sukcesi i fondeve garantuese nuk është i garantuar dhe se varet nga mënyra e funksionimit të tyre. Në përgjithësi, vendet e zhvilluara, me sistem më të qëndrueshëm financiar dhe bankar, kanë qenë më të suksesshëm në krijimin dhe rritjen e bizneseve të reja dhe si rezultat edhe në krijimin e vendeve të punës. Në disa raste edhe vendet në zhvillim, si Kolumbia dhe Paraguai, kanë arritur të krijojnë fonde të suksesshme²⁰.

Fonde ose mekanizma të tillë garantues për kredi, në teori, krijojnë rrezikun e moskthimit të kredive. Rreziku në këtë rast është i dyfishtë sepse edhe banka ka një rrjetë më shumë sigurie prandaj mund të ulë kriteret për dhënie të kredisë, por edhe biznesi kredimarrës ka më pak nxitje të paguajë kredinë. Mirëpo nuk ka të dhëna empirike që e mbështesin këtë pohim.


Një gjë e tillë nuk ndodhë për disa arsye. Fillimisht, fonde të tilla mbulojnë vetëm pjesërisht kredinë. Pjesa tjetër e mbetur është nxitje e mjaftueshme për bankat ta vlerësojnë klientin me standarde të arsyeshme. Mirëpo, për të arritur deri në një nivel të tillë, qeverive u është dashur të dizajnojnë fondet garantuese të kredive në atë mënyrë që ndarja e riskut mes tri palëve të përfshira (bankës, kredimarrësit dhe fondit) të jetë e tillë që t'i shtyjë të gjithë akterët t'i kryejnë obligimet e tyre në kohë. Për të arritur deri te një ndarje e tillë e riskut, janë bërë studime të historikut të kredive të mëhershme të të gjithë kredimarrësve.²¹

Në rast se një kredi nuk kthehet, qeveritë i kanë obliguar ligjërisht bankat të kalojnë nëpër disa faza para se të kërkojnë që ajo kredi të mbulohet nga fondi. Mekanizma të tillë përfshijnë kohë shtesë për të paguar këstet si dhe përfshirje e masave ligjore për të marrë në pronësi kolateralin, nëse ka qenë pjesë e kontratës së kredisë.²² Kjo tregon se sundimi i ligjit dhe zbatimi i tij ndikojnë në funksionimin e mirëfilltë të një fondi garantues kreditor.

²⁰ Irani Arraiz, Marcela Melendez and Rodolfo Stucchi "Partial credit guarantees and firm performance: evidence from Colombia".

²¹ Vienna Initiative "Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe".

²² Ted K. Bradshaw "The Contribution of Small Business Loan Guarantees to Economic Development"



Gjithashtu, interesi kryesor i bankave në raste të tilla nuk është thjeshtë vetëm dhënia e kredive ndaj bizneseve, por mbajtja e kredimarrësve si klientë për një periudhë më afatgjatë. Zakonisht, përfituesit e fondeve të tilla janë biznese të vogla, të cilat nuk u sjellin shumë fitim bankave. Për këtë arsye, kur japin kredi të tilla të garantuara prej fondit, bankat e konsiderojnë potencialin e kredimarrësve për t'u rritur dhe për të gjeneruar më shumë fitim për vetë bankën përpara se ta aprovojnë atë kredi²³.

Përveç kësaj, të dhënat në praktikë tregojnë se në rastet kur kanë filluar të implementohen mekanizma garantues për kredi, rreziku i përgjithshëm për kredi të dështuara ka rënë dukshëm. Kjo ka ndodhur pasi që kompanitë dhe bizneset që i janë shmangur rrezikut (ang.: *risk-averse*) të ndërlidhur me marrjen e kredisë, kanë pasur më shumë shtysë të marrin kredi pasi që kanë pasur garancinë e fondit. Kompanitë e tilla rrezikojnë më pak edhe në projektet që i implementojnë dhe financojnë dhe për këtë arsye gjasat janë më të vogla që këto kompani të reja të humbasin ekonomikisht²⁴.

Sa i përket modeleve të menaxhimit të fondit në rajon, ka lloje të ndryshme të fondeve ose mekanizmave garantues për kredi. Ato mund të jenë publike, private, në bashkëpronësi të qeverisë dhe entiteteve private dhe mund të jenë supranacionale, ku organizimi dhe administrimi i fondeve bëhet në nivel ndërkombëtar me kontributin e secilit shtet pjesëmarrës. Shumica e fondeve ekuivalente në Evropën Juglindore dhe Qendrore janë publike, të financuara plotësisht nga qeveria.²⁵

Prej shteteve që kanë fonde publike, 2/3 funksionojnë si korporata publike e 1/3 si struktura të integruara në qeveri. Shumica e fondeve i vlerësojnë kreditë në baza individuale e jo si portfolio të kredive. Megjithatë, për kredi me vlera të vogla preferohet të konsiderohen në portfolio e jo individualisht për arsye se zvogëlohen procedurat burokratike. Më shumë se gjysma e fondeve publike në regjion i delegojnë shumicën e detyrave të bankat, e një pjesë shumë e vogël e tyre kontaktojnë direkt me huamarrësin. Garancia zakonisht nuk

²³ Allan L Ridginga and George Haines "Loan guarantees: Costs of default and benefits to small firms"

²⁴ Alan Grimshaw and Robert O.Eidmister "SBA & fault Rates Selection Bias and Credit Deterioration"

²⁵ Vienna Initiative "Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe"

mbulon edhe interesin e fituar nga banka. Në shumicën e rasteve, huamarrësit paguajnë një tarifë drejt fondit para se të marrin garancinë, që përdoret për ta bërë fondin financiarisht të vetë-qëndrueshëm. Huamarrësit që dështojnë ta kthejnë borxhin ndaj bankës, paguajnë më shumë herën tjetër që kërkojnë garanci prej fondit ose mund edhe të refuzohen nga fondi. Përvoja e disa vendeve ka treguar që në disa raste edhe këto pagesa është dashur të marrin subvencione nga qeveria pasi që pa subvencione kanë qenë të papërbalueshme për bizneset e vogla dhe të mesme.²⁶

Në disa banka në regjion edhe pas zbatimit të fondeve garantuese kërkohet kolaterali si kusht për kredi²⁷. Teknikisht, kolaterali mund të kërkohet nga klientët që vijnë për kredi në banka, mirëpo nuk duhet që vlera e kolateralit dhe vlera e garancisë të kalojë vlerën totale të kredisë. Mirëpo, ky fakt tregon se edhe pas implementimit të fondeve garantuese për kredi, bizneset prapë është dashur të kenë kolateral që të garojnë me kompanitë e tjera për fonde në banka.

Vendet e rajonit, si edhe vendet e tjera të botës, vlerësojnë vazhdimisht performancën dhe efektin e fondeve të tilla garantuese. Performanca vlerësohet në dy aspekte: në shtrirje, që do të thotë sa e plotëson nevojën në treg për garanci kreditore, dhe në qëndrueshmëri financiare, që do të thotë sa mundet fondi vetë t'i mbuloj "humbjet" apo pagesat për kreditë e këqija. Këto dy aspekte janë më të lehta për t'u matur krahasuar me kriteret që përdoren për të vlerësuar efektin e fondit. Për ta bërë një gjë të tillë duhet kuptuar se sa kredi janë dhënë më shumë përmes fondit e që përndryshe nuk do të ishin aprovuar (ang.: *financial additionality*), si dhe si ka ndikuar fondi në mirëqenien e qytetarëve në përgjithësi duke u fokusuar në investime e punësim (ang.: *economic additionality*).

Tabela. 1. Fondet garantuese kreditore

Vendi	Lloji i fondit	Përqindja e garancisë	Shuma e fondit (milion euro)
Hungaria	Publik-privat	Deri në 80%	1,000
Rumania	Publik-privat	Deri në 90%	116
Polonia	Publik	50-80%	287
Bosnja dhe Hercegovina	Publik	50-90%	21

²⁶ Vienna Initiative "Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe"

²⁷ Vienna Initiative "Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe"

Slovakia	Publik	70%	73
Bullgaria	Publik	Deri në 50%	174
Slovenia	Publik	60-80%	190
Shqipëria	Multinacional	70%	40
Serbia	Publik	50-70%	400
Republika Çeke	Publik	60-70%	5,000
Kroacia	Publik	Jo fikse	800
Maqedonia	Publik	42%	15

5. Praktikrat e mira të menaxhimit të fondit

Një studim i publikuar nga Vienna Initiative (VI), në vendet e shënuara në tabelën nr.1, ka përmbledhur disa nga praktikrat më të mira sa i përket fondeve garantuese kreditore. Fillimisht, rekomandohet që fonde të tilla, veçanërisht ato që janë publike, të kenë një mandat të qartë që përcakton sektorin e synuar, pozitën në treg, dhe qëndrueshmërinë financiare të tyre. Mandati i fondit duhet të tregojë se cili është problemi dhe si fondi do të ndihmojë në zgjedhjen e atij problemi dhe, si do të arrijë të qëndrojë financiarisht stabil me të ardhurat që merren nga kredimarrësit. Të gjithë ata që kërkojnë garanci nga fondi paguajnë një tarifë anëtarësie. Kjo shumë, që sigurohet të jetë e përbalueshme për të gjithë ata që aplikojnë për kredi, kontribuon në qëndrueshmërinë financiare të fondit.

Për më tepër, sipas studimit të VI-së është shumë e rëndësishme të krijohet një komunikim i mirë mes fondit, qeverisë dhe bankës qendrore, që të harmonizohen përpjekjet e këtyre tre faktorëve për zhvillim ekonomik.

Po ashtu, nga studimi i VI-së del se është e rëndësishme të inkurajohet pjesëmarrja e sektorit privat në fonde të tilla, e posaçërisht pjesëmarrja e bankave komerciale që vetë do të japin kredi. Përvoja e vendeve tjera ka treguar që bankat i konsiderojnë klientët më me kujdes kur ato vetë janë pjesërisht pronare të fondit. Gjithashtu, qeveria duhet të synojë që të krijojë një ambient të tillë që të mos ketë nevojë më për fonde të tilla. Pra objektivi përfundimtar i fondit duhet të jetë inkurajimi i bashkëpunimit mes bankës e klientëve pa ndërmjetësimin e një pale të tretë.

Për sa i përket mbulueshmërisë së kredisë përmes garancisë, bazuar në hulumtimin e VI-së, mbulueshmëria më pak se 50% nuk ka treguar shumë efekt në rritjen e numrit të bizneseve të vogla që kërkojnë kredi prej bankave. Mirëpo, edhe mbulueshmëria shumë e lartë, për shembull 90-100%, ka pasur efekt negativ, sidomos tek bankat. Kjo për shkak se pothuajse e gjithë vlera e kredisë është mbuluar nga fondi dhe bankat nuk kanë qenë shumë të motivuara të monitorojnë e të shikojnë me kujdes klientët.

Vlerësimi i klientëve potencialë, sipas studimit të lartëpërmendur, preferohet t'i delegohet sektorit privat, përkatësisht bankave, pasi që sektori privat ka më shumë kapacitet dhe përvojë në këtë aspekt. Kreditë në shuma të mëdha rekomandohet të vlerësohen individualisht prej bankave, ndërsa kreditë në shuma të vogla rekomandohet të vlerësohen si pjesë të portfoliove kreditore.

VI-ja sygjeron që metoda e pagesave prej fondit ndaj bankave për kredi të këqija të dizajnohet në atë mënyrë që të jetë fitimprurëse për bankat. Duhet të ketë sa më pak procedura burokratike dhe metoda sa më efikase në mënyrë që bankat të bashkëpunojnë me fondin. Një faktor shumë i rëndësishëm është mbizotërimi i ligjit dhe zbatimi i tij në praktikë për sa i përket sistemit bankar, kolateralit dhe kthimit të borxhit. Për këtë arsye, secili vend, bazuar në karakteristikat e tyre, duhet të hartojë ligje e rregulla që ju japin bankave mundësi të kërkojnë kthim të borxhit dhe njëkohësisht i shtyjnë të bashkëpunojnë me fondin.

Për mbarëvajtjen e proceseve të lidhura me fondin, është shumë e rëndësishme të ketë vlerësime të performancës dhe efektit të fondit në vend. Nga studimi i VI-së rezulton që mbikëqyrja duhet të bëhet nga një trup i pavarur dhe apolitik ndërsa raportet mujore ose vjetore duhet të publikohen e të jenë të hapura për të gjithë.

6. Krahasimi i fondit garantues me subvencionet

Në krahasim me metodat e tjera për stimulim të ekonomisë, si subvencionet dhe investimet e përbashkëta, bankat preferojnë një fond të tillë garantues. Avantazhi i kësaj metode ndaj metodave tjera të subvencionimit qëndron në atë se bankat mund të grumbullojnë

borxhet ndaj tyre më shpejtë dhe me më pak shpenzime²⁸. Për më shumë, vendet e ndryshme preferojnë një sistem të tillë për të krijuar mundësi për bashkëpunim më të qëndrueshëm dhe më afatgjatë mes bankave dhe bizneseve të reja, një prej shtyllave kryesore të ekonomisë. Fonde të tilla shërbejnë si urë lidhëse mes bizneseve të reja dhe bankave, me qëllimin që marrëdhënia e këtyre dy palëve të vazhdojë më tutje pa mbështetjen e fondeve.

Përvoja e vendeve të tjera ka treguar që fonde të tilla garantuese preferohen më shumë se sa subvencionet. Për shkak se kreditë administrohen nga bankat komerciale, duke pasur parasysh faktin se bankat janë më efikase dhe më të mira se agjencitë publike në shpërndarjen e fondeve në vendet e duhura, në fund ato japin rezultate më të mira për ekonominë në përgjithësi krahasuar me metodat e administruara nga agjencitë publike.²⁹

Një avantazh tjetër i kësaj metode ndaj metodës së subvencionimit ose bashkë-investimit në biznese të reja është se në përgjithësi mjetet financiare që përdoren përgjatë programit janë dukshëm më të ulëta. Pra kostoja financiare e një programi të tillë garantues për kredi është më e vogël se sa e metodave tjera që mund të përdoren për t'u ndihmuar bizneseve të vogla dhe të reja. Kjo karakteristikë konsiderohet si avantazh, mirëpo pikërisht për shkak të kostove të ulëta mund të keqpërdoret për përfitime politike. Garanci kreditore mund t'u ofrohen shumë bizneseve që ndoshta nuk i plotësojnë kushtet për të marrë kredi të tilla vetëm se në fillim të lëshimit të garancisë nuk ka kosto. Për të shmangur situata të tilla, shumë vende i kanë kushtuar shumë kohë dizajnimin të programeve të tilla dhe zbatimit të kriterëve për garanci si dhe i kanë vlerësuar programet e tilla vazhdimisht.³⁰

7. Sfidat e implementimit të FKGK-së

Sfida e parë sa i përket efektivitetit të këtij fondi është shuma kredive të reja të cilat pritet t'i mbulojë. Siç u cek më lartë, për gjashtë vite ky fond pritet të gjeneroj rreth 360 milion euro kredi të reja, ndërkohe që

²⁸ Irani Arraiz, Marcela Melendez and Rodolfo Stucchi "Partial credit guarantees and firm performance: evidence from Colombia"

²⁹ Vienna Initiative "Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe"

³⁰ Vienna Initiative "Credit Guarantee Schemes for SME lending in Central, Eastern and South-Eastern Europe"

rreth 600 milion euro kredi të reja për biznese jepen brenda vetëm një viti nga bankat komerciale në Kosovë. Pra duke marrë parasysh madhësinë e këtij fondi krahas nivelit aktual të kreditimit të bizneseve nga ana e bankave, nuk pritet se do të ketë ndonjë ndikim thelbësorë në rritjen e kreditimit.

Në mënyrë që FKGK-ja të funksionojë, kërkohet të ndërmerren disa ndryshime paraprakisht. Nga përvoja e vendeve të tjera shihet se është e rëndësishme që bankat të kenë mundësi të marrin borxhin ndaj tyre përmes metodave tjera para se t'i drejtohen fondit. Kjo në Kosovë do të jetë e vështirë për t'u implementuar duke pasur parasysh që sistemi gjyqësor deri më tani nuk ka ndihmuar shumë në mbledhjen e borxheve në formë të hipotekave.³¹ Sipas Raportit të Bankës Botërore "Të bërit biznes në Kosovë 2015", nga 189 shtete të botës, Kosova renditet në vendin e 138 për nga zbatimi ligjor i kontratave dhe në vendin e 164 për nga zgjidhja ligjore e bankrotimeve. Kjo sfidë duhet adresuar para krijimit të fondit.

Është shumë e rekomandueshme pjesëmarrja e sektorit privat në fond si aksionarë³². Mirëpo, sipas koncept-dokumentit të MTI-së, sektori privat nuk ka treguar interes të marrë pjesë në një fond të tillë. Kjo mungesë e interesit duhet të adresohet dhe të bëhen përpjekje për integrim të sektorit privat në fond.

Një tjetër problem që paraqitet në Kosovë është mungesa e informatave për biznese që kanë bankat për shkak të informalitetit të lartë, që për momentin është një ndër problemet më të mëdha të sistemit bankar në Kosovë³³. Vlerësimi i klientëve do të jetë i mangët edhe pas krijimit të FKGK-së, gjë që do ta vështirësojë edhe funksionimin e mirë të fondit. Informaliteti i lartë ka shkaktuar që të ketë likuiditet të pashfrytëzuar në bankat kosovare³⁴.

Problemi tjetër, që paraqitet edhe në vendet e tjera, ka të bëjë me kolateralin. Një prej arsyeve të krijimit të FKGK-së është të lehtësohet qasja në mjete financiare e bizneseve që kanë pak ose aspak kolateral

³¹ Komisioni Evropian "Raporti I Progresit 2014 për Kosovën" Burimi: <http://bit.ly/1NumtMW>

³² USAID, Kosovo Credit Guarantee Fund Feasibility Study, May 2012

³³ Komisioni Evropian "Raporti I Progresit 2014 për Kosovën" Burimi: <http://bit.ly/1NumtMW>

³⁴ Komisioni Evropian "Raporti I Progresit 2014 për Kosovën" Burimi: <http://bit.ly/1NumtMW>

për ta ofruar si garanci. Mirëpo, bankat edhe pas krijimit të fondeve të tilla kanë vazhduar të favorizojnë klientët me më shumë kolateral dhe rrjedhimisht, kompanitë më të mëdha kanë pasur më shumë qasje në fonde duke lënë më pak hapësirë për kompanitë e vogla dhe të reja. Për më tepër, në vende tjera bazuar në kreditë e mëhershme e në studime të detajuara janë caktuar pagesat që duhet të bëhen ndaj fondit si dhe përqindja e mbulueshmërisë së kredive prej fondit. Studime të tilla do të duhej të bëheshin edhe në Kosovë para krijimit të FKGK-së.

Tabela 2: Përfshirja e praktikave të rekomandueshme në koncept-dokument të MTI-së

Praktika të rekomandueshme	Përfshirja në koncept-dokument
Mandat i qartë dhe i specifikuar	Pjesërisht
Protokol komunikimi me BQK-në dhe Qeverinë	Mungon
Aksionarë prej sektorit privat	Mungon
Tarifë prej klientëve	Pjesërisht
Vlerësim i klientëve prej bankave	Prezente
Mbulueshmëri 50-90%	Pjesërisht
Përqindja e kolateralit	Mungon
Vlerësimet e performancës	Mungon

8. Përfundimi dhe rekomandime

Të dhënat nga vendet e tjera që kanë krijuar fonde për garantim të kredive tregojnë se suksesi është i arritshëm. Në shumicën e rasteve një sistem bankar i qëndrueshëm ka qenë deri diku parakusht për mirëfunksionim.

Kryesisht, këto fonde shërbejnë për të rritur numrin e bizneseve të reja dhe atyre të vogla në treg, duke i harmonizuar interesat e bankave dhe bizneseve. Këto fonde në përgjithësi nuk e kanë përkeqësuar situatën për sa i përket moskthimit të kredive, mirëpo ka pasur edhe raste kur efekti pozitiv ka munguar. Duke marr parasysh përvojën me AZHK dhe kapacitetet financiare të FKGK, kjo e fundit nuk pritet të ketë ndikim të madh në rritjen e kreditimit apo uljen e normave të interesit për biznese.

Problemi kryesor që kanë bankat sot në Kosovë me të ashtuquajtura kredi jo-performuese është se kanë mungesë të informatave, sidomos nga auditime të jashtme, për të bërë vlerësimin financiar të klientëve të tyre. Mungesa e informatave i bën bankat të dyshojnë më shumë te bizneset e vogla si dhe çon në kredi jo-performuese. Ky problem nuk do të rregullohet automatikisht pas krijimit të FKGK-së.

Andaj, Instituti GAP rekomandon që:

- Ligji për FKGK-në të përcaktoj përqindjen e mbulueshmërisë si dhe tarifave nga përfituesit e FKGK-së;
- Të rishikohet mundësia e ristrukturimit të FKGK-së që të bëhet i përzier, me kontribut të qeverisë, donatorëve të jashtëm por edhe të bankave komerciale në Kosovë;
- Ligji për FKGK-në të qartësoj protokollin e komunikimit në mes BQK-së, FKGK-së, MTI dhe akterëve tjerë;
- Të punohet paraprakisht dhe paralelisht në forcimin e sistemit ligjor, sidomos në sektorin që merret me mbledhjen e borxheve;
- Të punohet paraprakisht dhe paralelisht në uljen e informalitetit tek bizneset;
- Të rregullohet me ligj çështja e kolateralit që mund të kërkohet prej klientëve nga ana e bankave.



Instituti GAP është Think-Tank i themeluar në tetor të 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheq profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të mbush zbrazëtitë në mes të qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të mbushë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

Instituti GAP mbështetet nga:



Kjo iniciativë është mbështetur nga:

